

Karikatura si kritikë

Agim Sulaj jeton me artin e tij, është burim i parë dhe i vetmi me të cilin jeton shpirtërisht dhe fizikisht. Jeta dhe puna e deritanishme e tij, mund të thuhet se ka qenë një kërkim dhe punë e vazhdueshme si piktor dhe karikaturist. Karikatura e Agim Sulajt është reale, e gjallë, duket si foto për nga mënyra e realizimit e kjo e bën fjalën e mesazhin e saj më të fortë e domethënës. Kjo së bashku me gjetjen herë me humor por shpesh me një satirë therëse e të paharrueshme, Karikatura e Sulajt të bën të qeshësh por më shumë të mendosh...

Intervistoi: Blerim Rrecaj

- Karikatura është mençuria e plakut dhe loja e fëmijës?

- Të dyja së bashku piktura dhe karikatura më kanë ndihmuar të zhvilloj imagjinatën figurative dhe ndërtojnë personin tim si artist. Piktura ime i referohet fëmijërisë, kujtime të mureve e lagjeve të vjetra të Shqipërisë, duke i përkëdhelur me një dritë imagjinare, subjektet e mia kthehen në ikona të një jete të thjeshtë por të shpenguar e të lirë. Ndërsa karikatura është një kritikë që unë iu bëj problemeve të jetës, anëve e dukurive më negative të njeriut, apo një grupi njerëzish. Karikatura nuk është një deformim sipërfaqësor i fytyrës së një njeriu, por kritika me mjete grafike e botës së tij. Janë të shumta temat që përfshijnë botën dhe problemet e lirisë së individit.

- Si fëmijë e përdornim shprehjen dhe prisnim se kush do gabonte



a do ta thoshte më mirë frazën: "Karikaturisti e karikaturoi një karikaturë me karakter karakteristik...". Sa ka karakter-karakteristik në karikaturat tuaja?

- Kjo që thatë është një lojë fjalësh e cila përdoret vetëm në shqip, pasi përsëritet me ritëm pa fund "K-ëja" por në thelb nuk ka asgjë për t'u trajtuar.

- Karikatura juaj "Servilizmi" më së miri do të rrinte në zyrat e "bosëve" politikanë, pse jo edhe "bosëve" të profesioneve tjera, apo jo?

- Kjo karikaturë është publikuar për herë të parë në Revistën "Hosteni", një revistë politike satiro-humoristike që publikohej në Shqipëri gjatë viteve të diktaturës, dhe i referohej pikërisht servilëve të atij regjimi...

-A i keni bërë ndonjëherë karikaturë vetes?

- Dikur në vitet e shkollës. Por miq dhe shokë më kanë bërë shpesh, duke filluar nga ata turq, portugezë, kubanë, gjermanë, italianë, francezë etj. **Dua të them që ndjehem sot qytetar i Evropës me gjak shqiptar**

-Jeni edhe artist-mërgimtar. Sa shpesh udhëtoni drejt Shqipërisë dhe si njeri me dy shtëpi (kam parasysh Shqipërinë dhe Italinë) cila është karikatura juaj për këto "dy shtëpi"...

- Shpesh shkoj në Shqipëri, kam përruar tri ekspozita të suksesshme në Galerinë e Arteve Kombëtare të Tiranës, por krijimtaria ime zhvillohet kryesisht në Itali e jashtë saj. Mendoj se jam një elektron i lirë dhe atdheu im figurativ është vendi ku vendos cilësinë time të punës.

- Diçka që doni ta thoni, që ju ka



mbetur në mbamendje e që bën pjesë në kujtimet e pashlyeshme?

- Janë të shumta mbresat, mund të përmend ditët që shkova në Prishtinë kur u shpall fituesi çmimit Grand Prix, në konkursin Botëror të Karikaturës organizuar mjeshtërisht nga karikaturisti Nexhat Krasniqi-Nekra. Kosova sapo ishte ndarë nga



kujtimet e hidhura të luftës e terrorit dhe me mjaft energji dhe dëshirë për të mbijetuar gjente forca dhe fonde për të organizuar një konkurrim botëror të karikaturës me temën: "Pavarësia". I kujtoj lapidarët e vegjël në çdo hap posa dilje nga Prishtina dhe i drejtoheshe Pejës. Ato ishin në kujtim të luftëtarëve të lirisë, fytyra fëmijësh dhe pleqsh e vajzash dhe djemsh, të cilët prehen në paqe, në tokën e tyre...Dua të them që ndjehem sot qytetar i Evropës me gjak shqiptar.



Biografia dhe vepra

Agim Sulaj lindi me 6 shtator 1960, në Tiranë në një familje intelektuale. Fillimisht publikimet e para i ka filluar me revistën "Hosteni" ku dhe është vlerësuar me çmime të rëndësishme kombëtare. Mbaron studimet e larta në vitin 1985 në Akademinë e Arteve në Tiranë. Që prej vitit 1995 jeton në Itali dhe merret vetëm me krijimtarinë e tij: pikturë dhe karikaturë.

Është vlerësuar me shumë çmime ndërkombëtare në karikaturë dhe ka ekspozuar dhe ekspozon pikturat e tij në galeri të rëndësishme e të njohura në Itali si Furni, Stefano Furni në Bolonjë, për të përmendur ekspozimin e tablosë së tij "Koka e Ali Pashë Tepelenës te Sulltani" në muzeun grek të Janinës në vitin 1990 vepër e cila ndodhet edhe sot atje.

Ekspozita „Europei Erranti“ Në Galerinë Furni (BO) ku veprat e Sulajt ekspozohen së bashku me autorë të mëdhenj të artit bashkëkohor Si Giorgio de Chirico, Balthus, Odd Nedrum Giacometti, etj.

Fitues i Grand Prix ne Konkurrimin Botëror të Karikaturës në Kosovë me temë „Pavaresia“ në vitin 2006. Çmimi i Parë në Torcoing të Francës në konkurrimin ndërkombëtar të Karikaturës etj., për një konsultim më të detajuar të veprimtarisë së tij mund te shihni faqen e tij web: www.agimsulaj.com

Mund të përmendim edhe karikaturën "Drejtësia" e vlerësuar me çmimin e pare në Bienalen e Parë Evropian në Portugali 2008, pastaj atë "I huaji"-vepër që trajton emigrimin e të tjera (të gjitha këto mund t'i shohim në vebfaqen e autorit).